



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202201011/6

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandohet bashkërendimi i punës për hartimin dhe nxjerrjen e aktit nënligjor ku të përcaktohen rregullat për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.*

MINISTRISË SË DREJTËSISË

Tiranë

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Tiranë

Të nderuar,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë i dënuari D. L., i cili pretendonte se nuk i ishte krijuar mundësia për të përfunduar arsimin e lartë. Më konkretisht ky i dënuar shpjegon se, kur ndodhej në gjendje të lirë ndiqte studimet në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, programi i studimeve të Ciklit të Parë (Bachelor) në "Menaxhim Agrobiznesi". Në muajin Shkurt 2018 është arrestuar pasi dyshohej se kishte kryer dy vepra penale dhe për rrjedhojë studimet janë ndërprerë. Pasi ai është dënuar me vendim të formës së prerë është transferuar në 21.12.2021 për të vuajtur dënimin në IEVP Korçë. Në këto rrethana, ankuesi ka treguar interes për të vijuar studimet, ndaj i është drejtuar në muajin Shkurt 2022 Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të përfunduar

arsimin e lartë. Sipas tij, kjo kërkesë nuk është trajtuar në mënyrë shteruese nga ky institucion e si rrjedhojë nuk i është garantuar e drejta për arsim.

Për më tepër, ai sqaron se kjo Drejtori fillimisht i është drejtuar Universitetit Bujqësor të Tiranës me shkresën Nr.D-124/1 prot., datë 03.03.2022, me kërkesën që të konsiderojë zhvillimin online të provimeve dhe frekuentimin e leksioneve të të burgosurit D. L., pasi frekuentimi fizik ishte i pamundur për shkak të masave kufizuese anti Covid dhe kostos së shoqërimit të një të burgosuri të sigurisë së lartë. Universiteti ka kthyer përgjigje me shkresën Nr.651/1 Prot., datë 05.04.2022, ku ka informuar se kërkesa është miratuar dhe ka përcaktuar datat e provimeve, duke caktuar dhe një person kontakti. Por, që nga kjo përgjigje Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve nuk ka marrë masa për të siguruar vazhdimin e arsimit të lartë, pavarësisht ankesave që i dënuari ka paraqitur në Ministrinë e Drejtësisë si dhe tërheqjes së vëmendjes dhe përcjelljes për trajtim të kërkesës së tij nga kjo e fundit në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Për verifikimin e kësaj ankese jemi interesuar me kërkesë dhe kërkesë të përsëritur për informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve¹.

Në përgjigjen që kemi marrë nga ky institucion me shkresën Nr. 12064/1 Prot., datë 23.11.2022 jemi vënë në dijeni për sa vijon:

“IEVP Korçë ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me Universitetin Bujqësor Kamëz, ku shtetasi D. L. ka qenë i regjistruar para dënimit të tij. Qëllimi ka qenë jo vetëm mundësia e vijimit të arsimit të lartë, por edhe gjetja e mënyrave të përshtatshme që ky i dënuar të vijonte shkollën, për shkak të aspekteve të sigurisë dhe largësisë fizike të I EVP-së me universitetin në fjalë.

Sa më sipër, pas ndërhyrjes edhe të DPB-së, është bërë e mundur që i dënuari D. L. të vijojë studimet këtë vit akademik 2022-2023 përmes platformës online, duke siguruar edhe kushtet e përshtatshme për ndjekjen e këtij procesi pranë I EVP Korçë.

Për shkak të pamundësive objektive që i dënuari të ndjekë çdo ditë leksionet online për një kohëzgjatje 3-4 orë, është dakordësuar me universitetin që i dënuari të pajiset me setin e leksioneve dhe të marrë pjesë online vetëm në orët e seminareve.

Duke theksuar se për raste të tilla I EVP-të e kanë objektivisht të vështirë të mundësojnë ndjekjen e arsimit të lartë për të gjithë të dënuarit e interesuar, qoftë edhe në rastet kur dakordësohet që procesi të ndiqet online, për shkak të orarit të veprimeve që kanë I EVP-të dhe për shkak të vijimit të komunikimeve online me

¹ Shkresat me nr. K2/D6-2 Prot., datë 27.07.2022; nr. K2/D6-3 Prot., datë 12.10.2022 dhe nr. K2/D6-4 Prot., datë 22.11.2022.

familjet për shumë të dënuar që kanë zgjedhur këtë mënyrë komunikimi me të afërmit e tyre.

Gjithsesi, predispozita jonë është për të lehtësuar aq sa është objektivisht e mundur për maksimizimin e kësaj të drejte të të burgosurve”.

Nga kjo përgjigje e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, por edhe nga komunikimi me ankuesin D. L., konstatojmë zgjidhjen e këtij shqetësimi të drejtë të tij dhe për këtë, vlerësojmë edhe përpjekjet e angazhimit të DPB-së dhe Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë. Por, nga ana tjetër çmujmë se e drejta për të vazhduar arsimin e mesëm dhe të lartë të të burgosurve nuk mund të ngelet vetëm në kuadër të përpjekjeve individuale, të veçuara dhe të parregulluara në mënyrë të detajuar mbi procedurat se si do të zhvillohet ky arsim apo formim profesional.

Referuar kuadrit ligjor mbi trajtimin dhe të drejtat e të burgosurve, evidentojmë se një nga risitë pozitive të sjella nga Ligji Nr.81/2020 “*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*”, është garantimi i të drejtës së të burgosurve për të vazhduar arsimin e mesëm dhe të lartë gjatë qëndrimit në IEVP.

Më konkretisht, në pikat 3, 4 dhe 9 të nenit 45 të Ligjit Nr.81/2020, parashikohet se:

“3. I burgosuri ka të drejtë të vazhdojë arsimin e mesëm dhe të lartë gjatë kohës së qëndrimit në institucion, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë.

4. Për aq sa është e mundur, arsimimi i të burgosurit integrohet me sistemin arsimor dhe sistemin e trajnimit profesional për të lehtësuar vijimin e arsimimit dhe trajnimit profesional pa vështirësi pas përfundimit të kryerjes së dënimit. Arsimi dhe trajnimi profesional i të burgosurit zhvillohet nën vëzhgimin e institucioneve të jashtme arsimore dhe të formimit profesional.....

9. Rregullat më të detajuara për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional.”

Në vijim, në dispozitat e fundit të këtij ligji, në nenin 91, pika 5 është përcaktuar se brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji ngarkohet Ministri i Drejtësisë dhe ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional të nxjerrin aktin nënligjor në zbatim të nenit 45, pika 9 të ligjit (që lidhet me përcaktimin e rregullave për mënyrën e zhvillimit të arsimit).

Referuar komunikimit që kemi patur me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, deri aktualisht nuk është nxjerrë akti nënligjor ku të përcaktohen rregullat për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Sqarojmë se Ligji 81/2020 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 23.07.2020 dhe ka hyrë në fuqi në datën 08.08.2020. Pra, afati 3 muaj është plotësuar në datën 08.11.2020. Ndonëse ka kaluar afati ligjor i parashikuar, ende nuk është miratuar, vonesë e cila ka sjellë si pasojë edhe mosrespektimin e kësaj të drejte të garantuar të të burgosurve.

Sikurse kuptohet edhe nga përgjigjja e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në praktikë hasen vështirësi për garantimin e të drejtës për arsim për të burgosurit. Kjo për arsye të elementëve të sigurisë që duhet të ruhen për këtë kategori personash dhe nga ana tjetër të infrastrukturës së nevojshme dhe buxhetit të dedikuar për të garantuar efektivisht këtë të drejtë. Ndaj është e nevojshme që në zbatim të detyrimeve ligjore, nxjerrja e aktit nënligjor mbi përcaktimin e rregullave për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale të shoqërohet edhe me masa të tjera, në mënyrë që vazhdimi i arsimit të mesëm dhe të lartë i të burgosurve të interesuar, brenda mureve të institucioneve të burgut të mos mbetet vetëm në kuadër deklarativ. Për të marrë një arsim cilësor, të burgosurit duhet të kenë akses në kompjutera, biblioteka (edhe ato online), materiale shkollore si dhe duhet të përmirësohet infrastruktura e dhënies së mësimi në distancë. Synimi i shprehur edhe në ligj është, integrimi i arsimit të të burgosurit, për aq sa është e mundur, me sistemin arsimor dhe sistemin e trajnimit profesional për të lehtësuar vijimin e arsimit dhe trajnimit profesional pa vështirësi pas përfundimit të kryerjes së dënimit.

Arsimi është një e drejtë themelore e njeriut dhe paraqet një mundësi për të burgosurit për një fillim të ri e që këta individë të bëjnë jetë më të mirë pas daljes nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. Gjithashtu, ofrimi i arsimit për të burgosurit është thelbësor për reduktimin e recidivizmit. Studime të ndryshme të realizuara në botë evidentojnë se të burgosurit që kanë marrë pjesë në programe arsimore/formim profesional gjatë kohës që ishin në burg kishin më pak gjasa të kryenin një shkelje tjetër të rëndë sesa ata që nuk janë përfshirë në këto programe. Arsimiti përmirëson mirëqenien mendore dhe fizike të të burgosurve, reduktimin e abuzimit me substancat, rrit shanset për punësim pas lirimit, rehabilitimin, zhvillimin personal dhe autonominë. Ndaj, vlerësojmë se arsimimi i të burgosurve është i rëndësishëm jo vetëm për sigurinë e komunitetit, por edhe për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre individëve në burgje.

Nga ana tjetër, sigurimi i të burgosurve me akses në shërbimet arsimore përmes teknologjisë (kompjuterat, etj) në ambiente të dedikuara për këtë proces është një mënyrë efektive për t'a arritur këtë. Raporti i OKB-së² mbi Arsimin në Paraburgim ka theksuar se globalisht, shumë të burgosur dhe të paraburgosur janë përballur me "barriera institucionale dhe të situatës" gjatë studimeve të tyre. Kjo i atribuohet veçanërisht "kapriçove personale të administratorëve dhe oficerëve të burgut... mungesës së bibliotekave... dhe materialeve edukative" (Munoz, 2009, 11).

Ndërsa Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në çështjen *Mehmet Reşit Arslan dhe Orhan Bingöl kundër Turqisë*, 2019, §§ 51-53, ka trajtuar një rast ku dy të burgosur të dënuar u paraqitën autoriteteve të burgut një kërkesë për të përdorur materiale audio-vizuale, kompjuter dhe pajisje elektronike me qëllim përgatitjen për pranim në universitet apo ndjekjen e arsimit të lartë. Ligji i brendshëm i lejonte të burgosurit e dënuar të vazhdonin studimet e tyre në burg për aq sa është e mundur duke pasur parasysh burimet e burgut. Gjithashtu ligji autorizonte përdorimin e burimeve të trajnimit audio-vizual dhe kompjuterëve, me akses në internet, nën mbikëqyrje, në dhoma të caktuara për këtë qëllim nga autoritetet e burgut në kuadër të rehabilitimit. Kjo mundësi sipas Gjykatës, përbënte një mjet thelbësor për të të siguruar ushtrimin e vërtetë të së drejtës për arsim, pasi ajo u mundësonte të burgosurve të përgatiteshin për provimet për t'u pranuar në institucionet e arsimit të lartë dhe potencialisht për të vazhduar studimet e tyre. Në këto rrethana, Gjykata konstatoi se kërkesa e kërkuarit binte brenda fushës së veprimit të nenit 2 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së³.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut" si dhe në mbështetje të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive".

REKOMANDIMË:

² Report of the UN Special Rapporteur on the right to education of persons in detention. https://www.right-to-education.org/sites/right-to-education.org/files/resource-attachments/UNSR_RTE_of_Persons_in_Detention_2009.pdf

³ Guide on the case-law of the European Convention on Human Rights, "Prisoners' rights", European Court of Human Rights, updated on 31 August 2022, pg. 73. https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Prisoners_rights_ENG.pdf

1. Marrjen e masave të nevojshme dhe të menjëhershme për bashkërendimin e punës nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për përgatitjen dhe nxjerrjen e aktit nënligjor ku të përcaktohen rregullat për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.
2. Marrjen e masave të nevojshme dhe të menjëhershme nga strukturat e Ministrisë së Drejtësisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, për përlogaritjen e një buxheti të dedikuar për të garantuar efektivisht të drejtën e të burgosurve për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale
3. Marrjen e masave të nevojshme për analizimin e vonësës së përgatitjes të aktit nënligjor ku të përcaktohen rregullat për zhvillimin e arsimit të mesëm dhe të lartë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe nxjerrjen e përgjegjësive të strukturave dhe personave përkatës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "*Për Avokatin e Popullit*" i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca